

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit: Agjencioni Pyjor të Kosovës DK në të cilin e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim, kundër të paditurit nga baza e kontestit: Kompensim dëmi, pas mbajtjes së seancës kryesore me datën: 14.11.2013 në prezencë të palësve ndërgjyqëse, me datën: 18.11.2013 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- **OBLIGOHET**, i padituri që brenda afatit 7 ditor nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi t'ia paguaj paditësit shumen prej 378 euro ne emër te kompensimit të dëmi, me kamatë vjetore që paguhet në lartesine e mjeteve të deponuara ne bankat afariste pa destinim të caktuar, nga data e parashtrimit të padisë dt.24.04.2012, e gjer në pagesën definitive, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- **OBLIGOHET**, i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale, t'ia paguajë paditëses shumën prej 15 euro në emer të taksës për padi, si dhe gjykatës 15 euro taksë për përpilimin e aktgjykimit të gjitha këto në afat 7 ditor nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi me datë: 24.04.2012 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurit për kompensimin e dëmit që rrjedh nga vjedhja e pyllit.

I autorizuari i paditëses edhe në seancë kryesor edhe në fjalën perfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë e cila është e mbeshtetur në aktgjykimin e plotfuqishem dhe i kundërshtoi pretendimet e pales së paditur se vëllimi i masës drusore të shkaktuar me veper penale, matet jo vetem me mjetin transportues të hasur në vendin e ngjarjes por edhe masa drunore e cila është hasur ne vendin e ngjarjes e cila është e prer. Shpenzimet e procedurës i kerkoi.

I padituri që nga fillimi e kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë duke pretenduar se nuk është e vertet se unë i kam pasur më shume se katër metra dru ditën kritike, gjithashtu e kundërshtoi edhe çmimin e përilogaritjes së këtyre metrave.

Paditësit sh. të Çështjes paterc ue

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova:
aktgjykimi penal P.nr. i dt.24.11.2011 me datë të
plotfuqishmerisë 16.12.2011, udhëzimi administrativ nr.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të
LPK-së dhe erdhi në këto konkludime:

Faktin se i padituri i ka shkaktuar dëmin paditësit me datën
12.11.2009 gjykata e vërteton në bazë të Aktgjykimit penal
P.nr.

Kërkesa pronsore juridike për dëmin e shkaktuar është llogaritur në
bazë të udhëzimit administrativ MA-NR.12/2005 i Ministrisë së
Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës.

Gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar konform
dispozitave të neneve: 158 në lidhje me nenin 185, par.1, 2 dhe 4 të
Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (i vjetri i aplikuar në këtë rast).

Gjykata, lidhur me caktimin e kamatës vjetore, u bazua në nenin 277,
par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të aplikueshëm në rastin
konkret, ndërsa, lidhur me lartësinë e saj, u bazua në lartësinë e
mjeteve të deponuara në bankat afariste për një vit pa destinim të
caktuar.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 452
paragrafi 1 i të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t'ia
paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në
dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.Nr.84/2012 datë: 18.11.2013



UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e
pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat 7 ditor nga dita e pranimit së
të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj gjykate.